



Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave
Personale i Republikës së Shqipërisë

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e
Republikës së Kosovës

DEKLARATA MBI BASHKËPUNIMIN E MËTEJSHËM

NDËRMJET KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHE
AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, REPUBLIKA E KOSOVËS

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në Republikën e Kosovës dëshirojnë të shprehen me një deklaratë të përbashkët, duke afirmuar bashkëpunimin e tyre aktual dhe gatishmërinë e tyre për të vazhduar bashkëpunimin e ndërsjellë.

Ky bashkëpunim do të reflektojë shkëmbimin e praktikave më të mira të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet ekspertëve të të dy institucioneve që kanë të bëjnë me fushat e mëposhtme:

- Zhvillimin legjislativ;
- Projektet e themeluara e të financuara nga Komisioni i Bashkimit Evropian dhe Institucione të tjera Financiare Ndërkombëtare;
- Bashkëpunimin në veprimtarinë ndërkombëtare, me synimin për të arritur një zgjidhje të harmonizuar të problemeve të ndryshme,
- Shkëmbimin dhe adoptimi i praktikës më të mirë në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike, të përdorur gjatë procesit të inspektimit, rregjistrimit, njoftimit etj.

Të dy institucionet janë të vetëdijshëm për nevojën e pashmangshme për të rritur bashkëpunimin midis autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, me synimin për të krijuar një zbatim uniform të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave që ekzistojnë në vende të ndryshme.

Mendimi i të dy autoriteteve është që ky bashkëpunim do të jetë edhe më i ngushtë përmes shkëmbimit të informacionit mes tyre dhe, si rezultat i pritshëm do të jetë, mbrojtja maksimale e të dhënave për qytetarët.

Mjetet dhe mënyrat e bashkëpunimit do të parashikohen në Memorandumin e Mirëkuptimit.

*Për Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave
Personale të Republikës së Shqipërisë*

*Për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të
Dhënave Personale të Republikës së Kosovës*

Flora Çabej (Pogaçe), Komisioneri

Ruzhdi Jashari, Mbikëqyrësi